

Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Bazuar në nenin 12.1 dhe 40.2 "c" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, lidhur me nenin 20.4 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, nenit 40.2 "b" dhe 41.2 "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **28 qershor 2018**, mori këtë:


VENDIM
PËR APROVIMIN E KORNIZËS AFATMESME TË SHPENZIMEVE BUXHETORE
2019-2021

1. Me këtë vendim aprovohet Korniza Afatmesme Buxhetore 2019-2021 e Komunës së Vushtrrisë, konform Qarkores Buxhetore 2019/01 e lëshuar nga Ministria e Financave me të cilën caktohen kufijtë buxhetor të buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2019-2021.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
3. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.



Nasuf Aliu

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri


Në bazë të nenit 12.2, pika "d" në lidhje me nenin 40.2, pika "c" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-40, si dhe nenit 41.2, pika "ç" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më **28 qershor 2018**, merr këtë:

VENDIM
PËR PÛRKRAHJEN FINANCIARE PËR BOTIMIN E LIBRIT "TRASHËGIMIA
ARKEOLOGJIKE E KOMUNËS SË VUSHTRRISË"

1. Me këtë vendim aprovohet kërkesa me nr. 03-104/02-0016166/18, e datës 04.04.2018, për përkrahjen financiare për botimin e librit të **Enver Rexhës**, në shumë prej një mijë (1000.00) euro.
2. Obligohet autori i këtij libri që tridhjetë (30) ekzemplarë të këtij libri të i'a dhurojë Bibliotekës së Qytetit të Vushtrrisë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.



Nasuf Aliu


Kryesues i Kuvendit



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRISË-OPËSTINA VUÇITRË	
01 Nr. / Br	173/18
Nr. i fq. / Br. st	- 1 -
Data: / Datum	28.06.2018
VUSHTRARI - VUÇITRË	



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 8, paragrafi 1 nënparagrafi 3, nenin 10, paragrafi 2 në lidhje me nenin 15, paragrafi 1 nënparagrafi 1 të Ligjit Nr. 04/L -060 për mbeturina, nenin 12, pika (d), si dhe nenin 17.1, pika (f) të Ligjit 03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 41.2, pika (ç) të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **28 qershor 2018**, mori këtë:

VENDIM
PËR APROVIM TË ANALIZËS TEKNIKE TË PIKAVE TË GRUMBULLIMIT TË MBETURINAVE

- 1.Me këtë vendim aprovohet Analiza teknike e pikave të grumbullimit të mbeturinave.
- 2.Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria e Inspektimeve.
3. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.



Nasuf Aliu

Kryesues i Kuvendit



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITRN

01 Nr. / Br. 174/18

Nr. i fq. / Br. st. -1-

Data: / Datum 28.06.2018

VUSHTRRI - VUČITRN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12 nën "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 41.2, pika "ç" dhe nenin 92, paragrafi 1, pika a të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më **28 qershor 2018**, merr këtë:

V E N D I M
PËR MIRATIM TË NISMËS PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E STATUTIT
TË KOMUNËS

- 1.Me këtë vendim miratohet nisma e Kryetarit të komunës, 02 Nr.799-1/18 e datës 8.6.2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Vushtrrisë 01nr. 58/11, datë 28.4.2011.
- 2.Ndryshimet dhe plotësimet e Statutit të komunës do t'i hartojë komisioni i cili formohet me vendim të veçantë të Kuvendit të komunës.
- 3.Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.



Nasuf Aliu


Kryesues i Kuvendit



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISE - OPSTINA VUCITRA

01 Nr. / Br 175/18

Nr. i fq. / Br. st -1-

Data: / Datum 28. 06. 2018

VUSHTRRI - VUCITRA



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12.2, pika "d" të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenit 41.2, pika "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 28 qershor 2018, merr këtë:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E
STATUTIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISE

1. Me këtë vendim formohet komisioni për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Vushtrrisë në këtë përbërje:

- 1.1 Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit (AKR);
- 1.2 Safet Idrizi, anëtar i kuvendit (PDK);
- 1.3 Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit (koalicioni LDK, LVV, AKR, AAK dhe Nisma);
- 1.4 Idriz Muzaqi, (shef i shërbimit juridik në QKMF);
- 1.5 Haki Maloku, (zyra e kryetarit).


2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi, i cili ka për obligim që t'i hartojë ndryshimet statutare dhe të njëjtat duhet t'ia ofrojë Kuvendit të komunës për aprovim.

3. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.



Nasuf Aliu

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Në bazë të nenit 12.2 “d”, 17 “k” të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, nenit 41.2”ç” të Statutit të Komunës së Vushtrrisë dhe nenit 6, paragrafi 6.7, pika “c” të Ligjit Nr.02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më **28 qershor 2018**, merr këtë:

V E N D I M

PËR THEMELIM-FUNKSIONALIZIMIN E QENDRËS PËR QËNDRIM DITOR PËR FËMIJË ME NEVOJA TË VEÇANTA NË FSHATIN NEDAKOC

1. Me këtë vendim themelohet-funksionalizohet Qendra për qëndrim ditor për fëmijë me nevoja të veçanta në fshatin Nedakoc.
2. Obligohet Kryetari i komunës të emërojë një koordinator për funksionalizimin dhe menaxhimin e qendrës nga pika 1 e këtij vendimi.
3. Koordinatorin në bashkëpunim me Kryetarin e komunës dhe Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale, autorizohet që të angazhohet dhe komunikojë me OJQ-të e fushës përkatëse dhe institucionet tjera (Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale me qëllim të funksionalizimit të kësaj qendre.
4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.



Nasuf Aliu

Kryesues i Kuvendit



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË OPSTINA VUČITRA

01 Nr. / Br 177/18

Nr. i fq. / Br. sf -1-

Data: / Datum 28.06.2018

VUÇITRA - VUČITRA



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës - Vushtrri

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më **28 qershor 2018**, pas shqyrtimit të Draft-Planit të Veprimit për Transparencë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2018, duke u bazuar në nenin 12.1, pika "d" të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 12 të Statutit të Komunës, nenin 8 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 01/2015 për Transparencë nëpër Komuna, si dhe nenin 2 të Rregullores për Transparencë 01Nr.99/13, dt. 25.04.2013, mori këtë:


VENDIM
PËR DHËNIE NË DISKUTIM PUBLIK

- 1.Me këtë vendim jepet në diskutim publik Draft-Plani i Veprimit për Transparencë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2018.
- 2.Diskutimi publik fillon nga data 5 korrik 2018 dhe zgjat deri më 25 korrik 2018.
- 3.Obligohet Zyra komunale për informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për Transparencë në Komuna dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013.
- 4.Obligohet Zyra e informimit që si propozues i draft-planit në fjalë të organizojë diskutimin publik konform Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 01/2015 për Transparencë në Komuna dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013. Gjithashtu obligohet zyra e sipërcekur që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantojë Kuvendit të komunës në rastin e shqyrtimit të dytë të draft-planit në fjalë në mbledhjen e kuvendit në muajin korrik 2018.
5. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Nasuf Aliu


Kryesues i Kuvendit





Republika e Kosovës


Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Në bazë të nenit 12.2, pika "d" në lidhje me nenin 40.2 pika "c" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-40 si dhe nenit 41.2 pika "ç" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më **28 qershor 2018**, merr këtë:

VENDIM PËR KTHIMIN E MJETEVE FINANCIARE KOMISIONIT EVROPIAN

1. Me këtë vendim bëhet kthimi i mjeteve financiare Komisionit Evropian në vlerë prej 18,113.51 €, nga projekti "Bashkëfinancim me donatorë" në kuadër të Drejtorisë për Shërbime Publike, me kod të programit 18184, sipas DEBIT NOTE me Nr.3241801144 të parashtruar nga Komisioni Evropian më datë 28.5.2018.
2. Autorizohet Drejtoria për Shërbime Publike që t'i ndërmarrë veprimet e nevojshme për kthimin e mjeteve financiare të cekura në pikën 1 të këtij vendimi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Shërbime Publike dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Nasuf Aliu


Kryesues i Kuvendit

